



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



PSH .nr. 933/19
952/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtuar nga operatori ekonomik: OE “D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk”-Gjakovë si dhe OE: N.SH.T “VIKTORY COM & COMPANY MURSELI” SH.P.K-Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik: “SH. DRINI COMPANY SH.P.K; BERISHA COM SH.P.K”-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa E I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. të prok:632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, më datën: 04.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk”-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa E I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. të prok:632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

I.APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE: N.SH.T “VIKTORY COM & COMPANY MURSELI” SH.P.K-Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa E I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. të prok:632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

III.ANULOHET, njoftimi për dhënien të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa E I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr. të prok:632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë.

dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk”-Gjakovë, aprovohet si e bazuar si dhe ankesa e OE: N.SH.T “VIKTORY COM & COMPANY MURSELI” SH.P.K-Gjakovë, aprovohen pjesërisht si e bazuar, ankuesve iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VII .Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Sqarim rreth inicialeve për procesin e prokurimit :

Autoriteti kontraktues në tekstin e më poshtëm AK ;

Operatori ekonomik në tekstin e më poshtëm OE ;

Dosja e Tenderit në tekstin e më poshtëm DT ;

Njoftimi për Kontratë në tekstin e më poshtëm NJpK ;

Ligji për Prokurim Publik-në tekstin e më poshtëm LPP;

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publiken tekstin e më poshtëm- RRUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit në tekstin e më poshtëm –OSHP;

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik në tekstin e më poshtëm –KRPP

Operatori ekonomik ankues OE “D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk”-Gjakovë , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.12.2019 me nr. 933/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

“Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa E I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr.të prok:632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 51, 52, 56, 59, 60 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE : N.SH.T “VIKTORY COM & COMPANY MURSELI” SH.P.K-Gjakovë , si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.12.2019 me nr. 952/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:

“Ri-Shpallje Mirëmbajtja e autorrugëve Pjesa E I-rë- Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane” me nr.të prok:632-19-7809-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 56, 59, 60, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 24.12.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:15.01.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: “DT GROUP & Florida & CoKosova” : Pretendimi i parë ankimorë i OE ankues është se AK pa të drejtë e ka eliminuar OE ankues me arsyetim se i njëjti nuk plotëson kërkesat për kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit.

Me qenë se në vendim për rishqyrtim AK nuk ka dhënë përgjigje/arsyetim konkret për eliminimin e OE ankues, eksperti shqyrtues është bazuar në raportin e vlerësimit të komisionit vlerësues i cili raport është shënuar më lart në këtë raport të ekspertizës.

Gjashtë shqyrtimit dhe analizimit të lëndës kemi hasur se OE “DT Group” ka ofruar listën e projekteve të realizuara në të cilën listë gjenden 25 projekte, andaj vlerësojmë se për çfarëdo paqartësie për cilin do projekt AK konfrom nenit 72.3 të LPP-së ka mund të kërkoj informata sqaruese prej OE me qenë se OE ankues është me çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë.

Vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar dhe se AK nuk i është dashur ta eliminoj OE pa kërkuar sqarim shtesë për kontrata/projektet të cilat i konteston.

Pretendimi i dytë ankimorë është se OE i rekomanduar për kontratë “Drini Company”, të njëjtat pajisje që i ka ofruar për këtë kontratë i ka të angazhuara në Lot.2 të këtij aktiviteti dhe se OE i rekomanduar nuk ka mundësi të realizoj projektin për këtë arsye.

Sqarojmë se në rast se OE i rekomanduar për kontratë pajisjet që i ka të angazhuara për lot.2 dhe të njëjtat i ka ofruar edhe për lot. 1, atëherë vlerësojmë se OE e ka të pamundur realizimin e projektit pasi nuk mundet ti ketë të njëjtat pajisje në të njëjtën kohë në dy vende të ndryshme, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Pretendimi i tretë ankimorë është se OE “EI Bau” i ka të lëshuara me qera pajisjet të cilat i nevojiten për realizimin e këtij projekti dhe se i njëjti për këtë arsye duhet eliminuar. PO ashtu OE ankues pretendon se OE EI Bau nuk ka plotësuar kërkesën për dy pastrues të borës me shpëmdarës kripe - mini, duke pretenduar se OE ka ofruar vetëm një pastrues - mini në pajtim me kërkesën e AK-së. Konsiderojmë se dhënia me qera e pajisjeve nga EI Bau një kompanie tjetër (në këtë rast OE Victory) nuk paraqet ndonjë shkelje apo bazë për eliminimin e OE, sepse fitues i këtij projekti mund të jetë vetëm një OE, dhe në rast të shpalljes fitues të cilit do nga këta dy OE nuk do të kishte pengesa për shfrytëzimin e e makinerisë/pajisjeve.

Me gjithë atë sa i përket pretendimit ankimorë se OE EI Bau nuk ka plotësuar kërkesën për dy pastrues të borës - mini, pas analizimit të ofertës së OE EI Bau vlerësojmë se OE EI Bau për këtë kërkesë ka ofruar një pastrues -mini në pajtim me kërkesat e dosjes ndërsa pajisja dytë është kamion i madh Mercedes modeli Unimog U400 me peshë totale 12500 kg. Bazuar në këto që u cekën më lartë konsiderojmë se edhe kjo pikë ankimore është e bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: “Murseli & Victory” - Pretendimi kryesor i OE ankues Murseli&Victory është se AK pa të drejtë e kanë eliminuar OE me arsyetim se i njëjti nuk plotëson kërkesat e AK-së për kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit dhe se nuk plotëson kërkesat për makinerinë. Bazuar në raportin e vlerësimit AK po ashtu si arsyetim për eliminim të këtij OE ka thënë se nuk ka deklaratën për specifikacion teknik.

Fillimisht sa i përket kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, ashtu si në rastin e OE ankues të parë, AK para se ta eliminoj OE ankues, konform nenit 72 të LPP ka mund të kërkoj informata sqaruese prej OE për të gjitha kontratat që janë kontestuar nga ana e AK-së, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar. Sa i përket pajisjeve të ofruara, AK - komisioni vlerësues ka konstatuar se “Lista e Pajisjeve e prezantuar nuk është e pranueshme pasi që askund nuk ceken mjetet e punës për tu përdorur në këtë tender, dhe të dhënat/specifikat pajisjeve nuk janë cekuP’.

Pas analizimit të shkresave të lëndës kemi gjetur se OE ankues në listën e pajisjeve tek rubrika ku duhet shënuar të dhënat e pajisjes, OE nuk ka dhënë të informata konkrete dhe në këtë rubrikë ka shënuar “Në pronësi dhe në marrëveshje me El Bau”. Me gjithë këtë kontrata e qiramarrjes me El Bau nuk jepte dhëna - specifika teknike të pajisjeve që kontraktohen dhe në këtë mënyrë nuk mund të vërtetohet se pajisjet që merren me qera a i plotësojnë kërkesat e AK-së ose jo, andaj në këtë pikë vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Ndërsa sa i përket arsyetimit të fundit të AK se OE nuk ka ofruar deklaratë për specifika teknik, ne nuk kemi mundur te gjejmë se ka pas kërkesë të tillë në dosje të tenderit.

Pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë falsifikim të dokumenteve, më konkretisht OE ankues pretendon se : OE Drini i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kontratave dhe referencave sepse të gjitha referencat e paraqitura janë të dyshime dhe do të kërkoj te verifikohen nga AK MI sepse është një kontratë me dy referenca, referenca 2014-15 po e njëjta është 2016-17, kurse kjo referenca 2016-17 është me kontratë të viti 2014-15 pretendojmë se është e falsifikua Referenca 2, 2017-18 është 260.040.22.

Kurse OE Berisha Com ka referencë 58,500.00.

Sqarojmë se eksperti shqyrtues i prokurimit i OSHP-së nuk ka autorizim e as kapacitete teknike të shqyrtoj këto pretendime ankimore.

Në anën tjetër në rast se AK ka dyshime me vërtetësinë e këtyre dokumenteve mund të kërkojnë informata sqaruese nga OE.

Ndërsa nëse OE ankues edhe më tutje dyshon në vërtetësinë e dokumenteve të lartcekura, se të njëjtat janë falsifikuar, OE mund ti drejtohet organeve kompetente për trajtimin e rasteve të tilla.

Pretendimi i tretë ankimorë është se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat për pajisje, konkretisht 2 pastrues bore mini dhe 2 kamion me minimum 7 ton.

Pas analizimit të ofertës të OE Drini Company , kemi gjetur se në listën e pajisjeve të ofruara për këtë aktivitet OE Drini ka të paktën 4 pajisje në pajtim me kërkesat e AK-së për pastrues bore mini, ato janë dy pastrues “Bucher CityCat 2020”, një kamionetë Mercedes modeli Unimog U90 dhe një pastrues “Bochung”. Ndërsa sa i përket kërkesës për dy kamion 7 ton, OE në listë ka ofruar kamionin me targa 07-546 për të cilin si dëshmi ka ofruar një foto, dhe një kamion me targa 07-639 për të cilin nuk kemi mund të gjejmë dëshmi dokumentare.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se ky pretendim ankimorë është pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “DT Group& Florida& CoKosova” të aprovohet si e bazuar, ndërsa

ankesa e OE :”Mursemi & Victory” të aprovet si pjesërisht e bazuar , ndërsa të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

AK KK Gjakovë me datë: 22.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik N.SH.T “VIKTORY COM & COMPANY MURSELI” SH.P.K-Gjakovë, me datë: 17.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pjesërisht pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk”-Gjakovë, me datë: 15.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 04.02.2020, ku ishin prezentë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues përfaqësuesit e OE-së ankuese, përfaqësuesit e AK-së si dhe eksperti shqyrtues , u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-se parë ankues z. Xharavina deklaroj: Faleminderit GR i OE-ve mbesim ne tërësi pran ankesës se ushtruar, për shkak se konsiderojmë se jemi eliminuar pa te drejtë, ndërsa konsiderojmë se vendimi i Autoriteti Kontraktues KK-Gjakove me te cilin jemi eliminuar është jo objektiv si dhe është marrur me shkelje te shumta ligjore te cilat i kemi specifikuar ne mënyrë te detajuar ne ankese. Njehjerit e mbështesim ne teresi raportin e Eksperti Shqyrtues ne këtë ceshtje për shkak se ky raport i vërteton te gjitha pretendimet tona te cilat i kemi precizuar edhe ne ankese ku ndër te tjera thotë se i kemi dorëzuar edhe referencat lidhur me listën e projekteve për punët e kryera dhe atë: mirëmbajtja rutin dhe dimërore Aksi rrugor Bajramcurr _ fierz, Ak Kompania Floridha SH.P.K., 2. Mirëmbajtja e Autorrugeve Lot 1 Autoriteti Kontraktues Gjakove, 3. Ndërtimi – shtruarja me kubza betoni ne KK Gjakove, 4, ndërtimi i kolektorit beton arme dhe kanalizimi fekale ne rrugën mbi Lumin Prishtina te cilat referenca një kopje te tyre ia dorëzoj edhe panelit shqyrtues tani.

Duke u bazuar ne te gjitha këto te cilat u precizuan me larte theksojmë se me veprimin e AK KK-Gjakove duke na eliminuar neve si OE, ne rrezikohemi te dëmtohemi, për shkak se i kemi ndërmarr te gjitha veprimet

dhe përgatitjet e duhura lidhur me këtë AP sepse përveç pajisjeve të duhura dhe makinerive në kemi siguruar edhe të gjitha kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të këtij projekti.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE së dytë ankuese z. Qerimi deklaroj: Ne qëndrojmë prapa ankesës sonë dhe pajtohemi me mendimin Eksperti Shqyrtues, për këtë AP jemi që dy vite me Autoriteti Kontraktues dhe me Autoriteti Kontraktues, disa here OSHP e ka kthyer në rishqyrtim dhe Autoriteti Kontraktues ka shpall të njëjtin OE, ndërsa as tash OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson asnjë kriter ku i mungojnë referencat dhe makineritë. Kurse Kompania Lidere ka paraqit disa referenca me të njëjtën kontratë janë të cekur edhe në ankesë, Gjithashtu OE D&T nuk i plotëson asnjë kusht të Autoriteti Kontraktues kërkesë ka qenë që lideri të këtë mbi 60% të kërkesave, kërkesa është kanë të jetë makineria, referenca, OE në fjale nuk e ka asnjë makineri në pronësi dhe asnjë punëtor në listën e ATK.

Gjithashtu gjatë analizues kemi hasur në disa referenca që janë si të dyshimta kurse Kompania është hapur në vitin 2016 kurse kontratën e ka në vitin 2015 dhe referenca është leshur një ditë mas hapjes së kompanisë dhe vlera ka qenë mbi 400.000 e diçka, OE ka vlerë mbi 60.000.00 euro. Pra të dy këto kompani punojnë me dokumente të jashtëligjshme kërkojnë të marrin punë, kurse KA mundohet të aprovoj dokumentet që janë paraqitur në DT.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Halilosmani deklaroj: Unë si përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues mbesim mbrapa vendimit të Autoritetit Kontraktues, me këtë lende nuk jam marrur por e kam të shkruar nga Menaxheri. Për kompaninë D&T Kontrata mirëmbajtja rutinë në mes Autoriteti Kontraktues dhe fluidit ka përfunduar me 23.12.2017 kurse kontratën e prezantuar në mes flurides dhe D&T 30.12.2017 referencën e ka lëshuar me 28.12.2017. Këtu kemi dëshmitë që kemi kërkuar nga OE Po i dorëzoj panelit parashtrësën me dokumentacionet përcjellëse.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Halili deklaroj: Qëndroj prapa raportit të dhënë në Ekspertizë. Eliminimi i OE të parë është bërë i padrejtë nga Autoriteti Kontraktues, sa i përket OE të 2-të njëjt si i pari edhe për këtë kam konstatuar nëse ka pas ndonjë dyshim ka mund të kërkoj sqarime, problemi i vetëm tek OE i dytë është tek lista e pajisjeve tek rubrika ku është dashtë të jep pronësinë është me OE elbau, nuk janë të shënuar se cilat pajisjeje i kontraktujnë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së parë ankuese z. Xharavina deklaroj: Kështu që i propozojmë panelit shqyrtues të OSHP-së që ankesa e ushtruar nga Gr ynë i OE-ve të aprovohet në tersi si e bazuar, ndërsa njoftimi për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim si dhe propozoj që të rekomandoni që Gr ynë i OE-ve të shpallemi fitues për shkak se konsiderojë se jemi me të përgjegjshëm dhe

me çmimi me te lire qe është për 47% me i lire se sa OE i rekomanduar nga Autoriteti Kontraktues dhe njeherit do te ruhet buxheti i shtetit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së së dytë ankuese z. Qerimi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Halilosmani deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te hedhen poshtë ankesat e OE-ve si te pa bazuara dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:15.01.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues: “DT GROUP & Florida & CoKosova”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK pa të drejtë e ka eliminuar OE ankues me arsyetim se i njëjti nuk plotëson kërkesat për kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se gjatë shqyrtimit dhe analizimit të lëndës është vërtetuar OE “DT Group” ka ofruar listën e projekteve të realizuara në të cilën listë gjenden 25 projekte, andaj vlerësojmë se për çfarëdo paqartësie për cilin do projekt AK konfrom nenit 72.3 të LPP-së, ka mund të kërkoj informata sqaruese prej OE me qenë se OE ankues është me çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë, andaj konstatojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar dhe se AK nuk i është dashur ta eliminoj OE pa kërkuar sqarim shtesë për kontrata/projektet të cilat i konteston.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i rekomanduar për kontratë “Drini Company”, të njëjtat pajisje që i ka ofruar për këtë kontratë i ka të angazhuara në Lot.2 të këtij aktiviteti dhe se OE i rekomanduar nuk ka mundësi të realizoj projektin për këtë arsye.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se në rast se OE i rekomanduar për kontratë pajisjet që i ka të angazhuara për lot.2 dhe të njëjtat i ka ofruar edhe për lot.1, atëherë vlerësojmë se OE e ka të

pamundur realizimin e projektit pasi nuk mundet ti ketë të njëjtat pajisje në të njëjtën kohë në dy vende të ndryshme, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE “EI Bau” i ka të lëshuara me qera pajisjet të cilat i nevojiten për realizimin e këtij projekti dhe se i njëjti për këtë arsye duhet eliminuar. PO ashtu OE ankues pretendon se OE “EI Bau” nuk ka plotësuar kërkesën për dy pastrues të borës me shpëmdarës kripe - mini, duke pretenduar se OE ka ofruar vetëm një pastrues - mini në pajtim me kërkesën e AK-së.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se dhënia me qera e pajisjeve nga “EI Bau” një kompanie tjetër (në këtë rast OE Victory) nuk paraqet ndonjë shkelje apo bazë për eliminimin e OE, sepse fitues i këtij projekti mund të jetë vetëm një OE, dhe në rast të shpalljes fitues të cilit do nga këta dy OE nuk do të kishte pengesa për shfrytëzimin e makinerisë/pajisjeve.

Ndërsa lidhur me pretendimin e ankuesit sa se OE E1 Bau nuk ka plotësuar kërkesën për dy pastrues të borës – mini. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE E1 Bau, është vërtetuar se OE E1 Bau për këtë kërkesë ka ofruar një pastrues -mini në pajtim me kërkesat e dosjes ndërsa pajisja dytë është kamion i madh Mercedes modeli Unimog U400 me peshë totale 12500 kg, andaj bazuar në këto që u cekën më lartë konstatojmë se edhe kjo pikë ankimore është e bazuar.

Paneli shqyrtues në vazhdim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues: “Murseli & Victory” – dhe lidhur me pretendimin kryesor të OE ankues Murseli&Victory se AK pa të drejtë e kanë eliminuar OE me arsyetim se i njëjti nuk plotëson kërkesat e AK-së për kontrata të ngjashme në tri vitet e fundit dhe se nuk plotëson kërkesat për makinerinë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se bazuar në raportin e vlerësimit AK po ashtu si arsyetim për eliminim të këtij OE ka thënë se nuk ka deklaratën për specifikacion teknik.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se sa i përket kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, ashtu si në rastin e OE ankues të parë, AK para se ta eliminojë OE ankues, konform nenit 72 të LPP ka mund të kërkojë informata sqaruese prej OE për të gjitha kontratat që janë kontestuar nga ana e AK-së, andaj konstatojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Sa i përket pajisjeve të ofruara, AK - komisioni vlerësues ka konstatuar se “Lista e Pajisjeve e prezantuar nuk është e pranueshme pasi që askund nuk ceken mjetet e punës për tu përdorur në këtë tender, dhe të dhënat/specifikat pajisjeve nuk janë cekur’.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të shkresave të lëndës është gjetur se OE ankues në listën e pajisjeve tek rubrika ku duhet shënuar të dhënat e pajisjes, OE nuk ka dhënë informata konkrete dhe në këtë rubrikë ka shënuar “Në pronësi dhe në marrëveshje me “El Bau”. Me gjithë këtë kontrata e qiramarrjes me “El Bau” nuk jep të dhëna - specifika teknike të pajisjeve që kontrahohen dhe në këtë mënyrë nuk mund të vërtetohet se pajisjet që merren me qera a i plotësojnë kërkesat e AK-së ose jo, andaj në këtë pikë konstatohet se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Ndërsa lidhur me arsyet e eliminimit të AK-së, dhëne për OE ankues se OE në fjalë nuk ka ofruar deklaratë për specifika teknik, paneli shqyrtues duke u bazuar në analizat që eksperti shqyrtues i ka bere, konstaton se kjo pike nuk ka qenë kërkesë në dosje të tenderit, andaj ne pajtim me nenin 56.3 të LPP-së asnjë OE nuk mund të diskualifikohet për kërkesa të cilat nuk kanë qenë në FDT dhe NJP.

Lidhur me pretendimi tjetër i OE ankues është se OE i rekomanduar për kontratë ka bërë falsifikim të dokumenteve, më konkretisht OE ankues pretendon se : OE “Drini” i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kontratave dhe referencave sepse të gjitha referencat e paraqitura janë të dyshime dhe do të kërkoj të verifikohen nga AK MI sepse është një kontratë me dy referenca, referenca 2014-15 po e njëjta është 2016-17, kurse kjo referenca 2016-17 është me kontratë të viti 2014-15 pretendohet se është e falsifikua Referenca 2, 2017-18 është 260.040.22.

Kurse OE Berisha Com ka referencë 58,500.00.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton Sqarojmë se OSHP, nuk ka kapacitete dhe mekanizma teknike të shqyrtoj këto pretendime ankimore, nëse AK vërteton dyshimet e ngrutura si më lart AK është e autorizuar që të inicioi procedure në OSHP në pajtim me nenin 99 të LPP-së.

E po ashtu nëse OE ankues edhe më tutje dyshon në vërtetësinë e dokumenteve të lartcekura, se të njëjtat janë falsifikuar, OE mund të drejtohet organeve kompetente për trajtimin e rasteve të tilla.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesat për pajisje, konkretisht 2 pastrues bore mini dhe 2 kamion me minimum 7 ton.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të ofertës të OE Drini Company , është gjetur se në listën e pajisjeve të ofruara për këtë aktivitet OE “Drini” ka të paktën 4 pajisje në pajtim me kërkesat e AK-së për pastrues bore mini, ato janë dy pastrues “Bucher CityCat 2020”, një kamionetë Mercedes modeli Unimog U90 dhe një pastrues “Bochung”. Ndërsa sa i përket kërkesës për dy kamion 7 ton, OE në listë ka ofruar kamionin me targa 07-546 për të cilin si dëshmi ka ofruar një foto, dhe një kamion me targa 07-639 për të cilin nuk kemi mund të gjejmë dëshmi dokumentare, andaj duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë konstatohet se ky pretendim ankimorë është pjesërisht i bazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Komuna Gjakovë

1x1 OE - "D&T Group shpk & Florida shpk. & Horn & Co Kosova shpk"-Gjakovë

1x1 OE - N.SH.T "VIKTORY COM & COMPANY MURSELI" SH.P.K-Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.